

# AKT-THEMELIM

## I

### SHOQËRISË

#### DUATOURIST sh.p.k.

Ne mbështetje te Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,  
UNE, :

**1- Driton Ukimeri i biri i Haxhi-ut i datelindjes.11-09-1976, lindur e banues ne Prizren i paisur me leternjoftim me Nr.1008078528**

Sot me dt. 04/04/2022, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë Akt-  
Themelimi për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **DUATOURIST** sh.p.k. si

#### ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

#### Neni 1

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me  
Përgjegjësi të Kufizuar **DUATOURIST** sh.p.k. .

#### Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e  
organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i  
bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

#### Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **DUATOURIST** sh.p.k. .

#### Neni 4

Selia e shoqërisë është në , **Lagjja Shtiçen,Rruga Nacionale Kukës-Peshkopi Km.3,Ndertese private brenda ambjenteve te Aeroportit Kukës**. Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

*Neni 5*

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **DUATOURLIST** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

**Import-eksport.Agjensi udhetimesh.**

*Neni 6*

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njqind mije) leke** ndare ne **1** kuote . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakeve dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

*Neni 7*

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Driton Ukimeri dhe** kompetencat e saj përcaktohen në Statut.

*Neni 8*

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24<sup>oo</sup> te çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

*Neni 9*

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë t'i përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

*Neni 10*

Ky Akt–Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë

**DUATOURLIST** shpk

**ADMINISTRATORI**

**Ortaku**

**Driton Ukimeri**

